



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gazetari**

Lënda: Etika e Medias

<i>Pedagogu:</i>	Prof. asoc. dr. Bashkim GJERGJI
<i>Ngarkesa:</i>	4 ETCS (15 javë: 2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Viti/semestri:</i>	III/I

Përshkrimi: Përmes orë mësimore studentëve u jepet një panoramë e zhvillimit historik të etikës, shkollat dhe përfaqësuesit më në zë. Pas prezantimit të koncepteve e termave kyç, fokusi i lëndës përqendrohet në procesin e vetërregullimit të medias në kushtet aktuale. Flitet për rolin e medias në shoqëri, raportet me njerëzit e thjeshtë dhe politikën, për rolin e drejtuesve, redaktorëve, burimeve, për kodet etike, ndikimin e teknologjisë aktualisht dhe mediat e reja. Gjatë orëve shtrohen kazuse nga praktika e medias dhe studentët ftohen të gjykojnë mbi to duke strukturuar arsyetimin e tyre etik. Inskenohen gjithashtu situata konkrete që imponojnë vendimarrjen nga ana e studentëve, të cilët sjellin argumentet e tyre për vendimet e mbi këtë bazë zhvillohet diskutimi në auditor.

Temat e leksioneve:

1 Objekti i lëndës

Gjatë orës studentëve u flitet për përmbajtjen e lëndës, temat që do të ofrohen gjatë leksioneve, literaturën dhe detyrimet që duhen shlyer prej tyre gjatë semestrit. Studentë u përcaktohet që në krye një detyrë e organizuar dhe realizuar prej tyre në grup, sipas një pikësnyimi që sugjerohet nga pedagogu, por për të cilën kërkohet edhe mendimi i studentëve. Kjo orë shfrytëzohet gjithashtu për të sjellë para studentëve një subjekt nga zhanret letrare, artistike që evidentojnë ekzistencën e dilemave etike dhe procesin e ndërlikuar të vendimarrjes.

2 Rrymat dhe shkollat etike në rrjedhën e zhvillimit historik (I)

Ora e mësimit përqendrohet në terma e koncepte kyç të etikës. Flitet për fillesat e saj në shoqërinë kineze (Egjipti i lashtë, hebrenjte, etika indiane, etj.) Parimet e shpallura prej tyre shihen si tingëllojnë sot, a mund të praktikohen ato në kushtet e shoqërisë aktuale dhe pse vazhdojnë të tërheqin vëmendjen tonë.

3 Rrymat dhe shkollat etike në rrjedhën e zhvillimit historik (II)

Flitet për shkollën greke të etikës (Sokrat, Platon, Aristotel), për rrymat e tjera (Shopenhauer, Spenser, Darwin, Niçe, Kanti, Sartre) duke përdorur të njëjtën metodologji si në orën e mëparshme, për ta sjellë diskutimin në atmosferën e sotme shoqërore.

4 Një model arsyetimi etik.

Studentëve u flitet për pasqyrimin mediatik të një ngjarjeje, përshkruar nga autori Clifford Christian në SHBA lidhur me një aksident në një kinema. Theksi vihet në faktin se si u arsyetua nga ana e të dy redaksive për evidentimin apo mosevidentimin e emrave të viktimave. Nga shembulli i mësipërm, studentë ftohen për të sjellë shembuj nga media jonë. Diskutimi rreth vendimarrjes, me argumentet pro e kundër, do të vazhdojë në orën e seminarit pasues.

5 Probleme etike në sfondin e marrëdhënieve media – pushtet (I)

Trajtohen kompleksiteti i marrëdhënieve media – pushtet, domosdoshmëria e tyre, interesi i ndërsjelltë për shfrytëzimin e njera-tjetrës dhe aspektet etike që dalin në pah në këtë rast. Rasti i tipografit Zenger dhe Sullivan kundër NYT. E vërteta si instrument mbrojtës për njeriun e medias në sytë e opinionit publik dhe gjykatës.

6 Probleme etike në sfondin e marrëdhënieve media – pushtet (II)

Trajtohen kompleksiteti i marrëdhënieve media – pushtet, domosdoshmëria e tyre, interesi i ndërsjelltë për shfrytëzimin e njera-tjetrës dhe aspektet etike që dalin në pah në këtë rast. Studentët ftohen të diskutojnë për faktin se si i konceptojnë ata vetë këto marrëdhënie, duke u mbështetur në peizazhin politiko-mediatik shqiptar. Çfarë rrugësh mendojnë ata si efikase për amortizimin e presionit politik mbi gazetarin?

7 Raporti i medias me njerëzit e zakonshëm.

Rëndësia e vëmendjes, kujdesit për njerëzit e zakonshëm. Pse ka nevojë për një diferencim të kësaj natyre dhe cilat janë provat që një individ i thjeshtë duhet të sjellë për të ekspozuar shkeljen e të drejtave të tij nga ana e medias.

8 Provimi i ndërmjetëm.

Studentët kontrollohen për njohuritë mbi konceptet, termat dhe shkollat etike, por nëkohë ftohen të japin mendime, ose më saktë, të arsyetojnë mbi kazuse të ndryshme nga përditshmëria e medias.

9 Burimet e medias dhe pesha e tyre në pasqyrimin mediatik.

Flitet për dilemat dhe kontestimet nga ana e konsumatorëve të medias në lidhje me përmbajtjet e ofruara, për të ashtuquajturën “njohje skeptike”, për përdorimin e burimeve të dorës së parë dhe procesin e verifikimit. Përzgjedhja e burimeve dhe trajtimi i tyre (a duhen paguar ata, niveli i relatave mes tyre, etj.)

10 Fotografia, imazhi dhe reklama në aspektin etik.

Kultura e imazhit – si shfaqet, pesha e saj në komunikimin e sotëm dhe në kushtet e teknologjive të reja. Manipulimet, deformimet dhe vlera e korregjimeve, e verifikimit dhe e ballafaqimit brenda sfondit pluralist mediatik. Edukimi i konsumatorëve mediatikë për një reagim të kujdesshëm dhe përfitim të filtrave të arsyetimit të produktit mediatik që shfaqet përmes tyre.

11 Mediat e reja – a flitet më për etikë?

Zhvillimet aktuale mediatike dhe përfshirja në proces e qytetarëve gazetarë. Kanalet e shumta në përdorim dhe shfaqja në to e një sërë dukurish si cënimi i privatësisë, gjuha e fyerjes, e urrejtjes, qarkullimi i njoftimeve të rreme, rritja e përmasave të dhunës e pronografisë në rrjete të ndryshme, dëmtimi i strukturave sintaksore të të shkruarit, kultivimi i mosthellit, i mungesës së kreativitetit, etj. Në sfondin e çështjeve të evidentuara theksohet nevoja për standarde etike, që duhet të burojnë nga vlerat tradicionale të shoqërisë dhe imponojnë respektimin e tyre dhe të vlerave të reja që përftohen në kushtet aktuale.

12 Një media e përlulur (e kujdesshme).

Do të flitet për kujdesin e medias në kontakt e punë e sipër me burimet dhe me njerëz të ndryshëm. Rrugët mediatike dhe rrjetet sociale si mundësi të mëdha njohjeje e komunikimi, bazë për gjetjen e zgjidhjeve, uljen e tensioneve sociale, aplikim politikave të reja, procesin e socializimit dhe komunikimin organizativ. Rëndësia e proceseve vetërregulluese dhe niveli i tyre në vend.

13 Qartësia, saktësia, korrektesa dhe e drejta e replikës dhe e përgënjeshtimit.

Duke marrë shkak nga një sërë gabimesh, shkeljesh në transmetimin apo publikimin e përditshëm mediatik, flitet për detyrimin e njerëzve të medias në lidhje me përgatitjen e scripture-ve në mënyrë korrekte, të qarta në formulim, të sakta në adresimet, në sjelljen e fakteve, provave dhe zhvillimin e gazetarisë investigative si rrugë për zbulimin dhe reduktimin e dukurive negative. Evidentohet rëndësia e përgënjeshtimeve, e aplikimit të së drejtës për replikë si aspekte të reputacionit, seriozitetit dhe besueshmërisë në sytë e opinionit publik.

14 Media etike – syri dhe zëri i atyre që kanë nevojë për të.

Flitet për minoritetet, grupimet gjinore, fetare, brezat e ndryshëm brenda shoqërisë dhe nivelin aktual të pasqyrimin të tyre. Theksohet se media duhet të përmirësojë punën e saj në vazhdimësi për pasqyrimin e kategorive të mësipërme duke zgjeruar dhe duke u dhënë vendin e nevojshëm problemeve sociale,

kulturore. Gjithashtu shfrytëzohet tema në fjalë për të ritheksuar nevojën e ngritjes së standardeve profesionale, çka nënkupton një nivel të konsiderueshëm e të qëndrueshëm etik.

15 Kodet etike, përmbajtja dhe rrugët e zbatimit të tyre.

Flitet hartimin e kodit të parë shqiptar (1917) si dhe për ata aktualë. Nevoja për platforma të shpallura në medime. Edukimi dhe zhvillimi i debatit e dialogut për çështje etike, cilësitë e njeriut të medias, rolin e familjes/shoqërisë/edukimit e përvojës personale në ngjizjen e tipareve të tilla. Theksohet nevoja e kualifikimeve të vazhdueshme, rëndësia e mosaplikimit të standardeve të dyfishta, lufta kundër korrupsionit përmes dhuratave, marrëveshjeve të paparimta etj etj. Jepen fragmente filmash a dokumentarësh që evidentojnë punën dhe cilësitë e njeriut të medias.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- *Detyrim frekuentimi në:* 70% të seminareve

- *Angazhimi në seminare:*

20% e notës

- *Testi I:* në javën e 8-të

30% e notës

- *Kontrrolli përfundimtar:* provim me shkrim

40% e notës

- Gjithsej:

100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. JAMES AND STUART RACHEL, FILOZOFIA MORALE, DITA 2000, 2009

2. Jean Claude Bertrand, Deontologjia e Mediave, ISHM

3. Charles Ess, Etika e Mediave të Reja, ISHM, 2013

Literatura plotësuese:

1. B.Kovach&T. Rosenstiell, Flu: si të njohësh të vërtetën..., ISHM, 2013

2. Ph Patterson&L.Wilkins, Etika e Mediave, Ufo-Press, 2009

3. E Katz,Peters,Liebes&Orloff, Tekste kanonike të kërkimit në media, ISHM 2009

4. J.Dominick, Dinamika e komunikimit masiv, UET-Press, 2010